

Niveli Vendor në një Vështrim SHQIPËRIA

KORÇË

Qershor 2020

Në shkurt të vitit 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit si një marrëveshje trepalëshe midis Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Korçë. U caktua një pikë kontakti e bashkisë për programin ROMACTED nga Kryetari i bashkisë për të ofruar mbështetje dhe për të lehtësuar procesin e zbatimit të programit në nivel bashkie.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, në Korçë u ngritën zyrtarisht Grupi Komunitar i Veprimit (GKV), Grupi Institucional i Punës (GIP) dhe Grupi i Task-Forcës së Bashkisë (GTB).

Arritjet kryesore

DOKUMENTET VENDORE TË PËRGATITURA NË KUADRIN E ROMACTED

- Sondazhi për situatën bazë dhe kriteret përzgjedhëse të bashkisë;
- Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë - informacione të mbledhura për nevoja të administratës vendore për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të komunitetit;
- Vlerësimi i Nevojave në Nivel Komuniteti - identifikimi dhe njohja e karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, mundësive dhe kërkesave të tyre;
- Hartëzimi i Aktorëve të Interesuar - identifikimi i aktorëve të interesuar të të gjitha niveleve me qëllim krijimin e strukturave dhe sinergjive vendore;
- Hartimi i Listës së Prioriteteve të Komunitetit - janë identifikuar gjithashtu masat, mënyrat dhe aktorët, që kontribuojnë në arritjen e përbushjes së nevojave kryesore;
- Hartimi i Planit Vendor të Veprimit - përkthimi i nevojave në aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të dakordësuara mes anëtarëve të Grupit të Task-Forcës së Bashkisë;
- Llogaritja e kostove të aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit - duke marrë parasysh afate të parashikuara, numrin e aktiviteteve dhe numrin e përfituesve, gjë që ndihmon autoritetet vendore në planifikimin e buxhetit vjetor dhe në buxhetimin afatmesëm;
- **Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022**, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Korçë më 29 maj 2020.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE



- Tre anëtarë të GKV-së dhe katër anëtarë të GIP-së u trajnuan për "Planifikimin Strategjik Vendor me Pjesëmarrje" gjatë vitit 2018, për "Hartimin e Planeve të Përbashkëta të Veprimit për Integrimin e Romëve në nivel vendor" gjatë vitit 2019, kurse 12 pjesëmarrës të Grupit të Task-Forcës së Bashkisë u trajnuan për "Buxhetimin me përgjegjshmëri rome në nivel vendor" gjatë vitit 2020.
- Stafi i bashkisë dhe anëtarët e GKV-së u trajnuan për mënyrën e shkrimit të projekt propozimeve dhe për menaxhimin me sukses të projekteve në nivel komuniteti, duke u fokusuar tek programet e mbrojtjes sociale, aksesin në shërbimet sociale, etj.

STREHIMI DHE INFRASTRUKTURA

- Në bashkëpunim me anëtarët e GKV-së dhe Drejtorinë e Strehimit në Bashkinë Korçë, u përgatit një listë prej 48 familjesh rome dhe u përfshinë në projektin e rindërtimit të shtëpive, që iu paraqit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Në kuadrin e nismave të vogla në nivel komuniteti, në kuadrin e Programit ROMACTED, GKV-ja vendosi të rindërtojë çatitë e shtëpive të 15 familjeve rome në mars të vitit 2019;
- Pesë familje nga komunitetet rome dhe egjiptiane përfituan nga strehimi social me kosto të ulët ndërtuar nga Bashkia Korçë. Përzgjedhja e familjeve që plotësonin kriteret për këtë shërbim u miratua nga Këshilli i Bashkisë Korçë. Kjo është një arritje, pasi ajo garanton përfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian në programet sociale të Bashkisë. Skema e strehimit social me kosto të ulët u jep mundësi familjeve të marrin me qira shtëpi kundrejt një qiraje të vogël dhe Bashkia Korçë ka përgjegjësinë për të paguar diferencën në qira;
- U përgatit dhe u miratua nga Bashkia Korçë një kalendar për pastrimin e zonave publike të lagjes Kulla e Hirit.



PUNËSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL



- U zhvilluan tre sesione informuese në partneritet me Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe me Agjencinë Rajonale të Punësimit, të cilat kishin si qëllim kryesor shkëmbimin e informacioneve mes anëtarëve të GKV-së dhe këtyre institucioneve;
- Këto aktivitete çuan në referimin e 20 të rinjve në Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe Formimit Profesional;
- Pesë romë u punësuan nga Agjencia Rajonale e Punësimit si rrjedhojë e këtyre sesioneve informative (dy në sektorin publik dhe tre në sektorin privat).


ARSIMI DHE DIALOGU NDËRKULTUROR



- U organizuan aktivitete dhe evente informimin e komunitetit për mundësitë e ndryshme të arsimit, kuotat shtetërore dhe bursat;
- Pas nismës së mbështetur nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, 13 nxënës romë morën libra shkollorë falas;
- Më 24 prill 2018, u performua drama "Ena e Drunjte" nga Edmund Morris nga studentët romë me rastin e javës rome. Kjo u organizua gjithashtu në kuadrin e aktivitetit vendor të prezantimit të projektit, i cili kishte për qëllim promovimin e rëndësisë së fuqizimit të komuniteteve rome dhe integrimin e romëve në Bashkinë Korçë. Në këtë aktivitet morën pjesë 79 anëtarë nga komuniteti rom, përfaqësues të bashkisë dhe institucioneve vendore, nxënës shkollash, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe IRCA.

MASAT NDAJ COVID-19

- Informacioni u nda për komunitetet rome gjatë shpërthimit të Covid-19 në gjuhët angleze, shqipe dhe rome;
- U hartuan lista të familjeve dhe të moshuarve romë në Korçë, që kishin nevojë për mbështetje urgjente;
- Kryetari të Bashkisë dhe Grupit Institucional të Punës iu drejtua një kërkesë për nevojat urgjente të romëve në Korçë me shpërthimin e pandemisë COVID-19;
- Me kërkesë të GKV-së, zonat ku jetojnë komunitetet rome dhe egjiptiane u dezinfektuan me qëllim shmangien e përhapjes së virusit në këto zona, si në zonat e njohura si ish-Gjeologjia dhe ish Konvikti i Ndërtimit;
- Në lagjet e njohura si ish Gjeologjiku, ish Konvikti i Bujqësorës dhe ish Konvikti i Inxhinierisë u shpërndanë 120 paketa ndihme emergjente.



Strukturat e Programit

GRUPI KOMUNITAR I VEPRIMIT (GVK)
GRUPI INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)
GRUPI TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



GRUPIT KOMUNITAR TË VEPRIMIT (GVK)



Në Bashkinë Korçë u ngritën dy GKV me 7-9 anëtarë (nga të cilët pesë janë gra rome), që marrin pjesë në secilin GKV. Pjesë e GKV-ve janë OJQ rome, liderë komuniteti dhe të rinj romë. Takimet zhvillohen mesatarisht dy herë në muaj, në varësi të nevojave të komunitetit. Në total, nga muaji prill 2018 deri në mars 2020 janë zhvilluar 22 takime të GKV-ve me 272 romë (136 gra rome).

GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)



Grupi Institucional i Punës (GIP) përbëhet nga këta përfaqësues të autoriteteve vendore: drejtorja e strehimit, drejtorja e shërbimeve sociale, zyra vendore e punës, zyra rajonale e arsimit dhe drejtorët e shkollave. Në këto takime, të cilat organizohen një herë në muaj marrin pjesë mesatarisht gjashtë zyrtarë. Në total, janë organizuar 13 takime të GIP-ve me 145 përfaqësues nga autoritetet vendore.

GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



Struktura e Grupit të Task-Forcës së Bashkisë (GTB) varet nga tema e diskutimit dhe nga çështjet e ngritura nga GKV-të dhe GIP-të. Zakonisht, në takimet që mbahen çdo tre muaj marrin pjesë katër përfaqësues të autoriteteve vendore dhe shtatë anëtarë të GKV-ve. Në total, janë organizuar 11 takime të GTB-ve me më shumë se 200 pjesëmarrës romë dhe joromë.

Dokumente Strategjike Vendore

Plani Vendor i Veprimit

Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 u hartua përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke sjellë së bashku nevojat e komunitetit rom dhe mundësitë e bashkisë, si dhe duke përcaktuar burimet përkatëse. Plani Vendor i Veprimit u krijua në bazë të një metodologjie me pjesëmarrje, ku komunitetet romë, OShC-të romë dhe përfaqësuesit e autoriteteve vendore mundën të shkëmbenin nevojat dhe pikëpamjet e tyre për zgjidhjet e mundshme. Këshilli i Bashkisë Korçë e miratoi Planin Vendor të Veprimit më 29 Maj 2020.

Projekte

Të zhvilluara në kuadër dhe/ose financiar prej programit

- Qasja shumëdisiplinare për mbrojtjen e fëmijëve në Korçë - Përforcimi i rolit të rrjetit vendor për mbrojtjen e fëmijëve (MF) përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse me GKV-të romë dhe ngritja e njësisë të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel bashkie - u mbështetën përmes skemës së granteve të vogla të ROMACTED;
- OShC-të vendore në Bashkinë Korçë u mbështetën nga Lehtësuesja ROMACTED në aplikimin e projekteve të ndryshme të BE-së dhe disa organizatave (Fondacioni i të Rinjve të Ballkanit, Erasmus, dhe World Vision që adresuan punësueshmërinë dhe trajnimin e të rinjve). U miratuan dy projekt propozime, kurse një tjetër kaloi vetëm fazën e parë të procesit të aplikimit;
- Dy nisma afatshkurtra të komunitetit për strehim dhe punësim u mbështetën nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA).

Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

ROMACTED

Promoting good governance
and Roma empowerment
at local level

- Partneritet me agjencitë e dekoncentruara nën qeverinë qendrore: Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Agjencia Rajonale e Punësimit, Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoria e Arsimit;
- Shkëmbim i vazhdueshëm informacioni dhe ndërtim sinergjisë me Përfaqësuesin Rajonal të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Korçë, duke i ndihmuar anëtarët e GKV-së në hartimin e dokumenteve zyrtare, si dhe në raportimin për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, etj.;
- Rrjeti rajonal i OShC-ve rome dhe egjiptiane të mbështetura nga projekti i financuar nga BE ECSORI "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Romëve" zbatuar nga Qendra Shqiptare Kombëtare për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ANTTARC) në partneritet me Amaro-Drom dhe AFCR.

Kontaktet

Kryetari I Bashkisë Korçë: Z. Sotiraq FILO

Pika e Kontaktit në bashki: Z. Ilir ZGURI

Lehtësuesja e ROMACTED: Znj. Alketa Zallemi

